



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 4, datë 13.01.2011

MBI

KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2011

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 3, të Rregullores nr. 22, datë 19.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e R.Sh në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka depozituar në Autoritet, vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve, “Për miratimin e masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2011”. Meqenëse përcaktimi i masës së kontributit nuk ishte bërë në përputhje me Rregulloren nr. 22, datë 19.03.2010 të AMF-së, Autoriteti kërkoi rishikimin, i cili u bë nga Byroja në përputhje me rregulloren e sipërpërmendur.

Autoriteti konstaton gjithashtu se sipas raportimit të Byrosë, deri në datën 13.01.2011, fondi i kompensimit për vitin 2010, ka detyrime të papaguara nga shoqëritë e sigurimit.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për krijimin e fondit të kompensimit për periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2011, në masën 116,861,243 lekë, duke i shtuar kësaj shifre vlerën e detyrimit të papaguar të shoqërive të sigurimit për fondin e kompensimit për vitin 2010, sipas përllogaritjeve të Byrosë bashkëlidhur.
2. Ky fond duhet të derdhet në përputhje me nenin 3, paragrafi 10 i Rregullores nr. 22, datë 19.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.
3. Ngarkohet Byroja dhe shoqëritë e sigurimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI